



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

Seanca plenare e Kuvendit të Kosovës  
Nr. 02-55/16-07  
Prishtinë, më 28 dhe 29 qershor 2007  
Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

**PROCESVERBAL**

Seancën e kryesoi Kolë Berisha, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi Sabri Hamiti, anëtar i Kryesisë.  
Kryetari konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 76 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

**REND DITE**

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të 21 qershorit 2007,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Debat për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave në Kosovë, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të LDK-së,
4. Debat për Rininë në Kosovë, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të PDK-së,
5. Debat për zbatim të Rekomandimeve të Kuvendit dt. 7 korrik 2005 për çështjen e pensionistëve në Kosovë,
6. Debat për ndërtimin ilegal të banesave kolektive nga Qeveria e Serbisë në lagjet veriore të Mitrovicës, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të LDD-së,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për planifikimit hapësinor dhe
9. Shytimi i Rekomandimeve të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion lidhur me dhënien e licencës për hulumtime të minerare kompanisë "Kosova Resorce Company L.L.C."

Në fillim të seancës, kryetari i njoftoi deputetët e pranishëm se Kryesia e Kuvendit, në bazë të rregullave 6 dhe 23 të Rregullores së punës së Kuvendit, e ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka propozuar rendin e ditës për seancën e sotme. Në ndërkohë, Komisioni për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor kishte kërkuar që pika e shtatë: Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje të shtyhet për seancën tjetër të radhës.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e këtij komisioni. Kuvendi, me shumicë votash, vendosi që Projektligji për trajtimin e ndërtimeve pa leje të shtyhet për seancën tjetër të radhës.

Grupi parlamentar i AAK-së kishte kërkuar që pika e gjashtë: Debat për ndërtimin ilegal të banesave kolektive nga Qeveria e Serbisë në lagjet veriore të Mitrovicës të shtyhet për një seancë tjetër të radhës.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e këtij grupi. Kuvendi, me shumicë votash, vendosi që debati për ndërtimin ilegal të banesave kolektive nga Qeveria e Serbisë në lagjet veriore të Mitrovicës të shtyhet për një seancë tjetër të radhës.

Jakup Krasniqi, në emër të grupit Parlamentar të PDK-së, tha se kërkesat e grupeve parlamentare për të debatuar për çështje të caktuara duhen të shqyrtohen me kohë e jo pasi ta humbin aktualitetin.

Ai kërkoi që Kuvendi të deklarohet lidhur me procesin aktual politik që po kalon vendi.

Deputeti Fadil Geci kërkoi që Kuvendi të debatojë për shtyrjen e zgjidhjes së statusit politik të Kosovës.

Kryetari tha se kërkesat duhet të parashtrihen me shkrim dhe në procedurë të rregullt.

## 1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të 21 qershorit 2007

Procesverbali i seancës plenare të 21 qershorit 2007 u miratua pa vërejtje.

## 2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Sala Berisha-Shala i kishte parashtruar pyetje ministrit të Punëve të Brendshme lidhur me veprimet e kësaj ministrie për dhënien e dokumenteve në komunën e Drenasit.

Ministri Blerim Kuçi nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputetja Zylfije Hundozi i parashtroi pyetje ministrit të Transportit dhe të Postë Telekomunikacionit lidhur me asfaltimin e rrugës Xërxe-Ratkoc-Kramovik.

Ministri Qemajl Ahmeti iu përgjigj pyetjes së deputetes Hundozi.

Deputetja Nait Hasani i parashtroi pyetje ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit lidhur me veprimet e kësaj ministrie për vërtetimin e relikteve të zbuluara nga vërshimet në fshatin Vrellë, komuna e Istogut.

Ministri Astrit Haraqija iu përgjigj pyetjes së deputetit Hasani.